

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

"X H A S T " shpk

Në Tiranë, sot me dt. 01 mars 2001, un i quajtur i Agim Kraja, i Dautit dhe i Nazmies, i dl. 1968, lindë e banues në Tiranë, rruga "Siri Kodra" Nr. 256/1, në cilësinë e ortakut të vetëm themeloj shoqëri tregtare me përgjegjjsi të kufizuar në bazë të kriterëve themelore si më poshtë:

Neni 1

Shoqëria do të quhet "Xhast" shpk.

Neni 2

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresë rruga "S. Kodra Nr. 256/1.

Neni 3

Aktivitetin tregtar të saj shoqëria do ta shtrijë në Tiranë dhe në gjith territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet, por me vendim të ortakut të vetëm mund të priset në çdo kohë.

Neni 5

Administrator i përgjithshëm i saj do të jetë ortaku i vetëm Agim Kraja, i cili do të drejtojë gjith veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 000 lekë.

Neni 7

Shoqëria do të këtë për objekt veprimtarie:

-Tregtimi me pakicë i karburanteve.

-Tregtimi me pakicë dhe shumicë i të gjith artikujve industrial dhe ushqimorë, import eksporti i tyre.

Neni 8

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit në gjykatën e rrethit Tiranë.

Neni 9

Fitimi i realizuar nga veprimtaria e shoqërisë i përket në masen 100% ortakut vetëm.

Neni 10

Në gjith veprimtarinë e saj shoqëria do të udhhiqet nga të gjitha ligjet e shtetit në fuqi.

THEMELUESI I SHOQËRISË

ORTAKU I VETËM

Agim Kraja
[Signature]

STATUTI I SHOQËRISË

"XHAST"

Neni 1

F O R M I M I

Ortaku i vetëm Agim Kraja, i dl. 1968, banues në Tiranë, ka formuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Xhast" me seli në Tiranë rruga "Siri Kodra" Nr. 256/1.

Neni 2

Aktivitetin e saj shoqëria do ta ushtrojë në të gjithë territorin e shqiperisë dhe jashtë saj ku mund të hapë edhe axhensi apo filiale nëpër rrethe të vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet, por mund të priset në çdo kohë me vendim të ortakut themelues.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

1- Tregtimi me pakicë i karburanteve.

2- Tregtimi me shumicë dhe pakicë i të gjithë artikujve industrial dhe ushqimorë.

Neni 5

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë si dhe objektin e veprimtarisë, me vendim të ortakut themelues konform Ligjeve të shtetit Shqiptar.


Neni 6

Kapitali themelues i shoqërisë është 100 000 lekë, kontribut 100% i ortakut të vetëm. Ky kapital mund të shtohet me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 7

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Në veprimtarinë e saj, shoqëria do t'i përmbahet këtij statuti dhe gjithë Legjislacionit Shqiptar në përgjithësi duke ruajtur marrëdhënje korekte me të tretët.



Neni 8

Shoqëria do të ketë vullen e saj e cila do të përmbajë emrin, vendin dhe formën e madhësinë sipas vendimit që do marrë ortakun.

Neni 9

Shoqëria do të veprojë në bazë të ligjeve dhe të ekonomisë së tregut. Kjo merr përsipër të drejta dhe detyrime, kontraktore dhe jashtëkontraktore brënda kapitalit të saj. Ortaku i vetëm mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e shumës së mjeteve të investuara në të.

Neni 10

Shoqëria "Xhast" shpk, është pronë e themeluesit të saj i cili merr vendime në përputhje me Ligjet dhe këtë statut. Këto vendime janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit e shoqërisë.

Neni 11

Veprimtaria e shoqërisë do të drejtohet nga administratori i përgjithshëm i sa i cili do të jetë ortakun i vetëm Agim Kraja. Ky emron punonjës të ndryshëm për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë.

Neni 12

Administratori është i veshur me të gjitha kompetencat për drejtimin e shoqërisë pa kufizim brënda statutit dhe Ligjeve të shtetit. Ky kryen të gjitha veprimet dhe aktet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Neni 13

Përfaqsimi i shoqërisë i përket ortakut të vetëm dhe personave të prokuruar prej tij. Ai lidhë kontrata të ndryshme, heq e vendosë punonjës sipas nevojave të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 14

Veprimet ekonomike të shoqërisë mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Në fund të çdo periudhe ushtrimore, financierët nxjerrin bilancin kontabël të shoqërisë me llogari "FITIM" ose humbje mbeshtetur në Ligjin "mbi kontabilitetin" dhe në ato të sistemit fis-

kal. Bilanci miratohet nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë vendosë për krijimin e fondeve të ndryshme dhe të nevojshme për të garantuar vazhdimin e veprimtarisë, duke mbajtur fondin e akumulimit dhe atë rezervë, pasi të jenë likuajduar të gjithë debitorët, fitimi i mbetur i përket ortakut themelues.

Neni 15

Pas likuajtimit të detyrimeve fiskale dhe çdo lloj detyrimi tjetër, nga pjesa e fitimit, ortaku i vetëm mund të kontribuojë për zmadhimin e kapitalit në natyrë gjë për të cilën merr vendim.

Neni 16

Çdo veprim ekonomik e financiar administrata e shoqërisë e pasqyron në dokumentacionin përkatës konform kërkesave të Ligjeve.

Brënda një muaji nga regjistrimi i shoqërisë dhe fitimi i zotësisë juridike, ortaku i vetëm cakton ekspertin kontabël të autorizuar

Neni 17

Mardhënjet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmes të kontratave të punës konform Kodit të Punës. Në kontratë fiksohen të drejtat e dhe detyrimet dypalshe.

Neni 18


PRISHJA E SHOQËRISË mund të vijë nga çdo lloj shkakut e në çdo kohë. Në këtë rast ortaku vendos mbi mënyren e likuajtimit dhe cakton likuajtuesin i cili më parë bën likuajtimin e detyrimeve ndaj të tretve e më pas nxjerr bilancin përfundimtar.

Neni 19

Përsa nuk është shprehur në këtë statut, shoqëria i referohet Ligjeve në fuqi. Për çdo mosmarrveshje bëhen përpjekje për t'i zgjidhur me mirkuptim e në të kundërt i drejtohet gjykatës.

Neni 20

Ky statut u përpilue në katër kopje origjinale për në destinacionet e dhura dhe një kopje e tij mbetet si pjesë përbërëse e dokumentacionit të themelimit të shoqërisë.



Numri 21

Për çdo plotësim shtesë apo ndryshim të këtij statuti do të ndiqet e njëjta procedurë si për nxjerrjen e tij.

Tiranë, më 01 mars 2001

PËR ASAMBLENË THËMELUESE

ORTAKU I VETËM

Agim Kraja
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISË

DHOMA E NOTERVE

T I R A N Ë

Nr. 360 Rep.

V E R T E T I M

Sot me datë 18-03-2001 të vitit 2001 (dymbijëdhjetë), u paraqit para meje personalisht Z. Agim Kraja, i biri i Dautit dhe i Nazmijes i dl. 1968, lindur e banues në Tiranë, rruga "Siri Kodra" Nr. 356/1 me numër pasaporte 1138614, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar i cili deklaroi se ka themelue shoqërinë "Xhast" shpk me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me këtë vullnet ka përpiluar aktin e themelimit dhe këtë statut të cilët i nënshkroi para meje ndaj i vertetoi këto sipas Ligjit, un,

NOTE RE

Hasë Lirë Hajdari
[Signature]

